

**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN**

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e -III-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
13 mars 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 13:30.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Gresa Muli, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (Kryetar i komunës), Besim Muzaqi (Nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Refik Maloku, Fatmire Cecelia, Sylejman Mehulli dhe Bajrush Kosumi), përfaqësues nga OSBE-ja, si dhe nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Aliu tha se na kanë ardhur edhe disa propozime për t'i futur në pika të ndryshme.

Ai tha se në planin e punës së kuvendit të komunës e kemi pasur edhe draft rregulloren e punës së kuvendit dhe organeve të tij, por desha ta bisedojmë bashkërisht se si do të veprojmë me këtë. Ideja ka qenë që edhe draft rregulloren, por edhe draft-statutin të shkojmë bashkërisht si kuvend dhe t'i hartojmë këto dy dokumente.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se sa i përket statutit, komisioni ka që 1 vit që e ka përgatitur draftin, por kanë qenë disa probleme në mes subjekteve politike LDK – VV. Por, nëse janë eliminuar këto probleme mund ta dërgojmë edhe draft-statutin në kuvend.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – theksoi se ndoshta do të ishte mirë të shtyhet për një kohë dhe se kur do që të bëhet kjo rregullore, me qenë funksionale dhe të jetë e qëndrueshme për një kohë të gjatë.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri kërkoi që të përgatitet një propozim për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores së punës së kuvendit dhe të dërgohet në kuvend.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që kërkesat mos të futen në rend të ditës por të kthehen në drejtoritë kompetente.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – tha se kërkesa e pesë lagjeve nga fshati Stanoc i Epërm për ndihmë në vlerë prej 3500 euro konsideroj se duhet të hiqet nga rendi i ditës, pasi që si

projekt (rregullimi i shtëpisë së komunitetit) ka dështuar. Pasi që unë isha i pranishëm në atë takim dhe se lagjet nuk arritën që të merren vesh për lokacionin.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se nëse i heqim nga rendi i ditës t'i heqim dy kërkesat.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – deklaroi se këto kërkesa t'i adresojmë në drejtori, pastaj ata e vlerësojnë se si të veprojnë më tutje.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shkurt 2020;
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2019;
6. Shqyrtimi i peticionit i banorëve të lagjeve: “Bregaj”, “Haradinaj”, “Shala”, “Hasani”, “Maloku” dhe “Ibrahimi” dhe
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 shkurt 2020.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – tha se tek diskutimi im nuk është përfshirë shqetësimi im për mospjesëmarrjen e drejtorëve në mbledhjet e KPF-së dhe kuvendit. Ajo tha se fjala ime ka qenë më e gjerë, prandaj kërkoi që të përmirësohet në procesverbal.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin me përmirësime të datës 14 shkurt 2020.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko- financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për formim të komisionit vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – pyeti se a është ligjore që të jenë pjesë e komisionit gjithmonë anëtarët e njëjtë?

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore – deklaroi se neni 17 i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës parasheh që për secilin rast veç e veç të formohet komision. Ndërkaq, lidhur me atë se a është ligjore që të jenë pjesë e komisionit gjithmonë anëtarët e njëjtë, kjo varet nga kuvendi i komunës së kënd e voton (pra, për përbërjen e komisionit vendos kuvendi).

Gresa Muli, anëtare e KPF-së – për neve si LVV konsiderojmë që të jenë të njëjtit anëtarë të komisionit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – sipas meje, nëse janë anëtarët e njëjtë, ekziston rreziku potencial i korrupsionit.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – propozimin ne do ta japim në kuvend.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se edhe në takimin e mëparshëm nga ekzekutivi kanë qenë të propozuar Adnan Lahu dhe Berat Sadiku. Por, por seancës jemi dakorduar që nga ekzekutivi të jenë një përfaqësues nga LDK dhe një përfaqësues nga LVV, por edhe nga kuvendi të jenë një përfaqësues nga LDK e një nga LVV dhe një nga shoqëria civile.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – sipas meje, atë që e tha Ymeri që propozimet si nga ekzekutivi dhe nga kuvendi të jenë LDK dhe LVV nuk është në rregull. Konsideroj që do të ishte në rregull të jetë një përfaqësues nga opozita, nëse ka opozitë.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës – deklaroi se propozimi i Gresës ishte i qëlluar, që të jenë të njëjtit në shumicën e rasteve, por gjithsesi që profesionalizmi të mbizotërojë në përbërjen e komisionit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për dhënien e dekoratave.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – ne si komisioni kemi menduar që është më mirë në fund kuvendi i komunës të merr një vendim për caktimin e çmimeve, në mënyrë që mos t'i paraprijë komisioni me caktimin e çmimeve.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – paraqiti disa propozime që të përfshihen në këtë draft.

Mirëpo, pasi që është drafti i parë u kërkua që këto propozime të jepen në kuvend apo edhe gjatë konsultimit publik.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor i punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

6. Shqyrtimi i petitionit i banorëve të lagjeve: “Bregaj”, “Haradinaj”, “Shala”, “Hasani”, “Maloku” dhe “Ibrahimi”.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.

7. Të ndryshme.


Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë financiare për komunitetin.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që komuniteti ta njoftojë zyrtarisht komunën për këtë çështje, pasi në bazë të informacioneve si projekt ka dështuar, për shkak se komuniteti nuk janë pajtuar për lokacionin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:26.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Nasuf Aliu


Kryesues i KK-së dhe i KPF- së